

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zegjine Çaushi i nxori foton me lule dhe e lumtur krah dajës së saj, Merta Gremaj tregon si qëndron e vë rteta: Kurrën e kurrës, ai më kërcënoi...
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/zegjine-aushi-i-nxori-foton-me-lule-dhe-e-lumtur-krah-daj-es-se-saj-me-i401463
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:28:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ac93c4f2a210c5116594166f285b2b57b578cfea5b411f25c064e4a3218be7f7
TEKSTI	9fe5eeca0d3868e04f773d82797eea50851c92b8910cc1e6bc265f40476451c1
PAMJA	88b8d018f035824c3b918119c1b5c56f361d2d86409d004ae400441730dee72f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f0c988b8090b9e26a5a79c997eccd1ad775c7597eb7313a984a7434fbf00c680
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahato hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f0c988b8090b9e26a5a79c997eccd1ad775c7597eb7313a984a7434fbf00c680

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

17 Shtator 2026, 16:18

Zegjine Çaushi i nxori foton me lule dhe e lumtur krah dajës së saj, Merta Gremaj tregon si qëndron e vërteta: Kurrën e kurrës, ai më kërcënoi...



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Zegjine Caushi, dhe foto e postuar prej saj: daja i deputetes dhe ish-bashkejetuesja e tij

Ditën e sotme gjykata vendosi masën e sigurisë "arrest me burg" pa afat për Bledar Bakajn, dajën e deputetes së PS Zegjine Çausi, i cili pak ditë më parë plagosi me drapër ish-vjehrrin e tij, pasi theu urdhrin e mbrotjes që ishte vendosur ndaj tij për ish-bashkëjetuesen Merita Gremaj.

Kjo e fundit, pasi më herët denoncoi dhunën, përdhunimin dhe kërcënimet e ish-parterit të saj në një lidhje të drejtëpërdrejtë për "Shqipëria Live" në Top Channel, sqaroi të vërtetën e fotos së postuar nga deputetja e Partisë Socialiste, Zegjine Çausi, e cila deklaroi se Merita do të martohej me dajën e saj, por megjithatë dënoi çdo lloj dhune që mund të ishte ushtruar. Në foton në fjalë Merita dhe Bledari shfaqen të lumtur krah njëri-tjetrit, teksa e reja mban një buqetë me lule në duar.

Gremaj ka hedhur poshtë deklaratën e deputetes, duke u shprehur se nuk do të martohej kurrë me Bledaj Bakajn. Sa i përket fotos ajo sqaroi se ishte bërë në muajin qershor, nën kërcënimin e 52 vjeçarit.

Ajo po ashtu ka treguar se gjatë kohës që mbahej nga Bakaj nuk ka mundur të regjistrojë ndonjë prej episodeve të dhunës pasi nuk kishte celular.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Rajoni

FOTO-LAJM/ Vendimi i Hagës nuk e lë pa shpresë familjen e Rexhep Selimit, bashkëshortja e tij krahë fëmijëve. Gjithmonë krenarë e të fortë



Politike

"Çfarë duhet të ndodhë, që Jakup Krasniqi të vdesë në burg?" Spiropali e emocionuar, thirrje deputetëve: Të mbështesim financiarisht betejën për mbrojtjen e tyre

Zbulo më shumë artikuj >

Pjesë nga intervista:

Sidorela Gjoni: A do të martoheshit, cila është e vërteta?

Merita Gremaj: Unë me atë, kurrën e kurrës

Sidorela Gjoni: Kur është bërë foto?

Merita Gremaj: Kur kemi ikur në Fier me ble rroba. Si mund të merrem me një njeri që më dhunon, kërcënon, më keqtrajton

Sidorela Gjoni: Kush t'i ka dhuruar lulet në foto?

Merita Gremaj: Mi ka dhënë vajza e Nazmies. Foto është bërë se më kërcënonte

Sidorela Gjoni: I ke thënë deputetes se do martohesh?

Merita Gremaj: Jo, unë e kam nxjerrë jashtë. Donte Bledari të më fuste në punë dhe ajo thoshte në Roskovec.

Nexhi Beqiraj: Pse nuk e kenë denoncuar, të kërcënonte dhe nuk e ke denoncuar?

Merita Gremaj: Se thoshte ti po tregove do të të heq një këmbë dhe krah, do të bëj të vuash, e ka thënë edhe në komisarjat.

Sidorela Gjoni: Kur është bërë fotografia?

Merita Gremaj: Në muajin qershor

Sidorela Gjoni: Të këtij viti?

Merita Gremaj: Po

Eris Dhamo: Kur ka nisur dhuna për herë të parë?

Merita Gremaj: Ka qenë e vazhdueshme

Sidorela Gjoni: Edhe në qershor?

Merita Gremaj: Vetëm dy ditët e fundit e ndali dhunën se erdha në shtëpi për të kërkuar ndihmë, te familja ime

Sidorela Gjoni: Si reagues institucionet kur bëre denoncimin?

Merita Gremaj: Më thanë 'pse nuk erdhe më para?'. Po nuk kisha shanse

Sidorela Gjoni: Cilat janë provat që ke?

Merita Gremaj: Kam një telefon tjetër dhe ky akoma vazhdon me kërcënime edhe në shtëpinë time. Atje nuk kam mundur t'a regjistroj se nuk kisha telefon.

Sidorela Gjoni: Në polici ça provash ke dhënë?

Merita Gremaj: Kam dhënë prova. Unë faktikisht si person nuk doja kontradiktë, se gjërat më shumë agravoheshin

Sidorela Gjoni: A të ka marrë deputetja në telefon?

Merita Gremaj: Erdhi bashkë me babain e saj dhe solli vetëm rroba

Sidorela Gjoni: Pas denoncimit?

Merita Gremaj: Jo. S'kam kontakte, s'më ka marrë, asnjë takim

Sidorela Gjoni: Po të afërmit e Bledarit?

Merita Gremaj: Më kanë thënë të heq denoncimin se ka fëmijë, nuk mundem se jam e kërcënuar dhe e dhunuar. Po tani që babai im ndodhet në shtrat ca të bëj. Unë dhe nëna jemi si mos më keq.

Video credits © Top Channel



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Enjte 16:15

“Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi”, shteti shqiptar pas urdhrorit të nxjerrë nga Arbitri i Emergjencës: Do ta njoftojmë sot Aeroportin e Vlorës (REAGIMI I MIE)



Aktualitet

Theu masën e sigurisë dhe kreu 16 vjedhje në kryeqytet, arrestohet “skifteri” 34-vjeçar (VIDEO)

E Enjte 15:46



Aktualitet

ILD “vërejtje” gjyqtarës në Berat, i përlogariti gabim dënimin një shtetasi

E Enjte 15:20





🕒 E Enjte 14:59

Pas urdhrorit të arbitrazhit, Behgjet Pacolli i bën THIRRJE publike qeverisë: Rishqyrto qëndrimin dhe krijo kushtet për dialog



Aktualitet

Falsifikuan dokumentet për ndryshimin e emrit, pezullohen nga detyra dy zyrtarë në Tiranë! Shpallet në kërkim një 41-vjeçar

🕒 E Enjte 15:01



Aktualitet

"5 Maji" zonë e re për zhvillim, cilat janë njësitë zbatuese të përcaktuara me VKM për rindërtim

🕒 E Enjte 14:40



🕒 E Enjte 14:09

Dha alarm se në shkollën në Tiranë kishte bombë, protestuesi e thotë para gjykatës: Do e bëj sërish; Gjykata vendos ta lërë të lirë



Aktualitet

Vendimi i Hagës për katër ish-krerët e UÇK-së, veteranët dalin në protestë: Nesër tubim gjithëpopullor në Prishtinë

🕒 E Enjte 14:14

Aktualitet

Për pesë vite mori 16 leje, herën e fundit "u zhduk", dyshohet se Alket Rizai ka kaluar kufirin dhe fshihet në Shqipëri (DETAJET e fundit)

🕒 E Enjte 13:55 Newsbomb



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.